

PROCESVERBAL
nga seanca e 42-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 15.11.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë: Lazo Petrushevski, kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini, zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: L Lazar Trajçev.

Në seancë ishte i pranishëm edhe dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional: mr. Dragica Ljubevska, Emilija Janevska, Cvetanka Mitrevska, Goran Radunoviq, Lucija Gjurkoviq Dodevska, Maja Damevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë:/

Z. Petrushevski hapi seancën e 42-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 13:00 dhe u mbajt në ambientet e Agjencisë, Salla e Konferencave, kati i dytë.

Z. Petrushevski njoftoi se në seancë do të mungojë z. Trajçev për shkak se ndodhet jashtë vendit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 5 vota "pro", miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 41-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 29.10.2024.
2. Propozim për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër operatorit Total TV nga Shkupi për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR Televizioni SITEL SHPKNJP Shkup, për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenit 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
5. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI SONCE SHPKNJP Prilep, për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenit 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

6. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJ Shkup, për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
7. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJ Shkup, për shkelje të nenit 64 paragrafi 1 të LSHMAAV.
8. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV SHENJA SHPKNJ Shkup, për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.
9. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR TV SHENJA SHPKNJ Shkup, për shkelje të nenit 92 paragrafët 1 dhe 3 të LSHMAAV.
10. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit Neotel nga Shkupi, për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.
11. Propozim për marrjen e vendimit për Ribalancin e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.
12. Propozim-rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
13. Propozim-rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor të të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.
14. Propozim për miratimin e mjeteve financiare për rinovimin e 2 (dy) qasjeve shfrytëzuese në bazën elektronike të të dhënave të "Gazetës Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut".
15. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Shërbime shtypi.
16. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e propozuar nga seanca e 41-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 29.10.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për planifikimin strategjik dhe të drejtat e autorit Lucija Gjuroviq shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës kundërvajtëse kundër operatorit Total TV nga Shkupi për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se më 29 tetor të këtij viti, është kryer mbikëqyrje kontrolli ndaj këtij operatori dhe është konstatuar se ka ritransmetuar shërbime programore që nuk mbulohen me çertifikatë për regjistrim të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Pasi që më herët gjatë mbikëqyrjes së rregullt të këtij operatori për shkelje të të njëjtit nen të Ligjit është shqiptuar masë vërejtje publike, është propozuar të inicohet procedurë kundërvajtëse.

Këshilli i Agjencisë pasi shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit programor nr.10-4475/1 datë 30.10.2024 të Shoqërisë për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup dhe konstatoi shkelje të nenit 141 të LSHMAAV.

Këshilli njëzëri konkludoi kundër Shoqërisë për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup, të inicojë procedurë kundërvajtëse para gjykatës kompetente sepse me mbikëqyrjen e kontrollit programor është konstatuar se operatori në fjalë i cili sipas njoftimit të Agjencisë për komunikime elektronike, mund të kryejë veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, më 29.10.2024 për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbimet programore "Grand", "CNN", "Brazzers", "Reality Kings" dhe "Red Light" të cilat nuk mbulohen me çertifikatë për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Kërkesë për inicimin e procedurës kundërvajtëse para gjykatës kompetente për Shoqërinë për tregti dhe shërbime TOTAL TV SHPK Shkup.

Pika 3

Udhëheqësja e Spektorit për çështje programore, mr. Emilija Janevska, shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJ eksport-import Saraj Shkup, për shkelje të nenit 50 paragrafit 3 të LSHMAAV dhe nenit 22 paragrafit 2 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve. Shpjegoi se shkelja tek TV Klan Maqedoni është konstatuar nga mbikëqyrja e rregullt e kryer në shtator të këtij viti. Në kundërshtim të nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenit 22 paragrafit 2 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve, ky shërbim TV në muajin shtator kur është kryer mbikëqyrja, nuk ka shënuar njoftimet promovuese për serialin artistik "Doktori i mrekullive (Çudesniot doktor)" transmetuar disa herë gjatë ditës me sinjalizimin për mbrojtjen e të miturve. Për këto arsye, propozohet që transmetuesit t'i shqiptohet masë vërejtjeje publike me afat respektimi prej 20 ditësh dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse ai do të jetë në përputhje me kërkesat ligjore.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4127/1 datë 04.10.2024 dhe njëzëri konstatoi që SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJ eksport-import Saraj Shkup t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenit 22 paragrafi 2 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve sepse më 5 shtator 2024, nuk shënoi njoftimet promovuese për serialin artistik - "Doktori i mrekullive (Çudesniot doktor)" me sinjalizimin për mbrojtjen e të miturve.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, udhëzohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Rregulloren për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon ueb-faqen e Agjencisë.

Pikat 4, 5, 6 dhe 8

Z. Petrushevski, në konsultim me udhëheqësen e Sektorit për çështje programore mr.Emilija Janevska, propozoi që Pikat 4, 5, 6 dhe 8, meqenëse kanë të bëjnë me shkelje të të njëjtit nen të LSHMAAV dhe Rregullores për mbrojtja e të miturve, të shpjegohen me një hyrje dhe diskutim të përbashkët dhe më pas për secilin transmetues të votohet individualisht.

Udhëheqësja Janevska shpjegoi se shkeljet janë konstatuar me mbikëqyrjen e rregullt të kryer në shtator të këtij viti. Këto shkelje i referohen aplikimit të gabuar të sinjaleve paralajmëruese për mbrojtjen e të miturve në lidhje me programet e kategorisë së dytë. Bëhet fjalë për rrethin e verdhë në të cilin shënohet numri 8 dhe shenja "+", si dhe para fillimit të transmetimit të programeve, kur aplikohet kjo shenjë ka edhe tekst që përveç shenjës vizuale, shoqërohet me tekst që duhet lexuar nga drejtuesi i programit, se programi nuk është i përshtatshëm për moshat më të vogla se 8 vjeç. Ajo ka deklaruar se ky problem ka kohë që qëndron në disa media. Për këtë ka pasur edhe peticion në gusht dhe për këtë arsye në fund të gushtit të gjitha televizioneve u është dërguar shkresë ku tregohet se si duket shenja vizuale dhe shenja paralajmëruese për kategorinë e dytë të programit dhe është kërkuar që të respektojnë pamjen e shenjës siç është parashikuar në Rregullore. Mirëpo, nga mbikëqyrja e shtatorit, është konstatuar se në disa media akoma shenja nuk është në përputhje me dispozitat e Rregullores dhe për ato arsye janë konstatuar shkelje. Në TV Sitel është konstatuar se edhe në njoftimet e programit artistik, shenja vizuale nuk është në përputhje me Rregulloren, si dhe para fillimit të transmetimit të programeve, sinjalizimi nuk është në përputhje me Rregulloren. Dhe për këto arsye, edhe për TV Sitel dhe për të gjithë transmetuesit e tjerë propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike me afat respektimi prej 20 ditësh dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse do të respektojnë kërkesat ligjore. Asnjë nga transmetuesit për të cilët propozohen masat masa nuk ka dërguar deklaratë.

Z. Fidanoski pyeti nëse për të gjithë transmetuesit që janë monitoruar dhe që janë në Rendin e ditës ekskluzivisht është problem aplikimi jo i duhur i shenjës së kategorizimit sipas Rregullores apo sipas mendimit të Sektorit për çështje programore dhe përmbajtja mund të mos të jetë adekuat për kategorinë e moshës?

Udhëheqësja Janevska u përgjigj se kjo shkelje është ekskluzivisht për aplikimin e gabuar të sinjalizimit. Në TV Klan ka qenë për mospërdorim të sinjalizimit dhe nëse ka pasur program të kategorizuar në mënyrë të papërshtatshme, atëherë në bazë tjetër do të konstatohet shkelja.

Z. Petrushevski shpjegoi se Pikat 4, 5, 6 dhe 8 individualisht do t'i vë në votim të cilat kanë të bëjnë me shkeljen e nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve.

Votimi për pikën 4

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4124/1 datë 04.10.2024 dhe njëzëri konstatoi që SHTR Televizionit SITEL SHPKNJP Shkup t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve sepse më 2 shtator

2024, njoftime dhe episode të disa serialeve artistike janë transmetuar me aplikim të gabuar të sinjalit paralajmërues për programin e kategorisë së dytë (8+), përkatësisht:

- Në njoftimet e programit të transmetuar "Lojërat e martesës (Braçni igri)", "Përadha e Sevdës (Prikazna za Sevda)", "Vajza nga dritarja (Devojkata od prozorecot)", në tërësinë e paraqitjes së përcaktuar me ligj të aplikuar shenja paralajmëruese për programin e klasifikuar në kategorinë e dytë, mungonte *numri "8" dhe shenja "+"*, si tregues të grupmohës së shikuesve për të cilët është destinuar programi;
- Para fillimit të transmetimit të reprizave/premierat e episodeve të serialeve artistike "Nektari dhe mjalt (Pelina i med)", "I dyshuari (Osomničen)", "Lojërat e martesës (Braçni igri)", "Përadhë për Sevdën (Prikazna za Sevda)" dhe "Vajza nga dritarja (Devojkata od prozorecot)", nga të gjithë pamjen e përcaktuar me ligj të sinjalistikës paralajmëruese të aplikuar për programin e klasifikuar në kategorinë e dytë, mungon: *numri "8"; shenjën "+", teksti i shkruar dhe i lexuar i paralajmërimit*, si tregues të grupmohës së shikuesve për të cilët destinohet programi;
- *Numri "8" dhe shenja "+"* mungonte gjithashtu dhe në sinjalistikën e aplikuar vazhdimisht gjatë transmetimit të episodeve.

Në pajtim me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, udhëzohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Rregulloren për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4126/1 të datës 04.10.2024 dhe njëzëri konstatoi që Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive TELEVISIONI SONCE SHPKNJP Prilep t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve për shkak se më 5 shtator 2024, premierat dhe episodet reprizë/edicionet në emisionet TV, me funksione të ndryshme mediatike, janë transmetuar me aplikim të gabuar të sinjalizimit për program të kategorisë së dytë (8+), konkretisht:

- Para fillimit të transmetimit të programeve, nga e gjithë pamja e parashikuar me ligj e sinjalizimit paralajmërues të aplikuar për programin e klasifikuar në kategorinë e dytë, mungon: *numri "8"; shenja "+", teksti i shkruar dhe i lexuar i paralajmërimit* - si tregues të grupmohës së shikuesve për të cilin është destinuar programi; dhe
- *Numri "8" dhe shenja "+"* mungon edhe në sinjalizimin e aplikuar në vazhdimësi gjatë një episodi/edicioni.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, udhëzohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Rregulloren për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4125/1 të datës 04.10.2024 dhe njëzëri konkludoi që SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJ Shkup, t'i shqiptoi masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafi 3 të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve sepse më 5 shtator 2024, episodet premierë dhe të ritransmetuara të serialit artistik "I egri (Yabani)" dhe episodi premierë i serialit artistik " etë të thyera (Kirik hayatlar)" janë transmetuar me aplikim të gabuar të sinjalizimit paralajmërues për programin e kategorisë së dytë (8+). Para fillimit të transmetimit të episodeve në tërësi të pamjes së parashikuar me ligj të aplikimit të sinjalistikës paralajmëruese për program të klasifikuar në kategorinë e dytë, mungon numri "8" dhe shenja "+", si tregues të grupmoshës së shikuesve për të cilat është destinuar programi.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, udhëzohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Rregulloren për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje juridike pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 8

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4122/1 të datës 04.10.2024 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV SHENJA SHPKNJ Shkup t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 50 paragrafit 3 të LSHMAAV dhe nenet 20 dhe 21 të Rregullores për mbrojtjen e të miturve sepse më 5 shtator 2024, njoftimet edhe episodet e serialit artistik " Luftëtari (Kızıl Elma)" janë transmetuar me

aplikim të gabuar të sinjalit paralajmërues për programin e kategorisë së dytë (8+), përkatësisht:

- Në njoftimet për programin artistik, nga tërësia e pamjes së parashikuar me ligj të sinjalistikës paralajmëruese të aplikuar për programin e klasifikuar në kategorinë e dytë, mungon numri "8" dhe shenja "+", si tregues të grupmoshës së shikuesve për të cilët është destinuar programi;
- Përpara fillimit të transmetimit të episodeve reprizë/ të serialeve me metrazh të gjatë, nga tërësia e pamjes së parashikuar me ligj të sinjalizimit paralajmërues të aplikuar për programin e klasifikuar në kategorinë e dytë, mungon: numri "8"; shenjen "+", teksti i shkruar dhe i lexuar i paralajmërimit, si tregues të grupmoshës së shikuesve për të cilin destinohet programi; dhe
- Numri "8" dhe shenja "+" mungon dhe në sinjalistikën e aplikuar vazhdimisht gjatë gjithë episodeve të transmetimit.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, udhëzohet që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale dhe Rregulloren për mbrojtjen e të miturve.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja Janevska ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup, për shkelje të nenit 64 paragrafi 1 të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se në kundërshtim me nenin 64 paragrafi 1 të LSHMAAV në shërbimin programor të TV21-M më 10 shtator, në një program është konstatuar transmetimi i deklaratës së bashkëbiseduesi, burimisht në gjuhën serbe, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe apo maqedonase, gjegjësisht në gjuhët në të cilat sipas lejes ky transmetues duhet të emetojë programin. Për këto arsye, propozohet që të shqiptohet masë vërejtjeje publike me afat harmonizimi prej 10 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit dhe më pas të kryhet mbikëqyrja kontrolli për të kontrolluar nëse transmetuesi do të respektojë Ligjin.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4095/1 të datës 04.10.2024 dhe njëzëri konkludoi që SHTR KOMPANI 21-M SHPKNJP Shkup t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 64 paragrafit 1 të LSHMAAV sepse më 10 shtator 2024, në programin "Pastel" deklarata e bashkëbiseduesit është transmetuar burimisht në gjuhën serbe, pa ofruar përkthim në gjuhën shqipe ose maqedonase.

Në përputhje me pikën 5 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas Aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022, urdhërohet që në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e nenit 64 paragrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Akvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje juridike pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 9

Udhëheqësja Janevska ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR SHENJA SHPKNJP Shkup, për shkelje të nenit 92 paragrafët 1 dhe 3 të LSHMAAV. Shpjegoi se neni 92 paragrafët 1 dhe 3 të LSHMAAV i referohen detyrimit për transmetimin e veprave audiovizuale maqedonase. Ditën kur është kryer mbikëqyrja, është konstatuar se TV Shenja nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar fillimisht si vepra audiovizuale maqedonase. Është konstatuar se atë ditë janë transmetuar 27 për qind dhe gjithashtu të paktën gjysma e këtij minimumi ligjor prej 30% nuk është transmetuar në periudhën nga ora 7:00 deri në orën 19:00. Nga mbikëqyrja u konstatua se i mungojnë 1 orë e 20 minuta e 40 sekonda për të realizuar minimumin e kërkuar për periudhën nga ora 07:00 deri në orën 19:00. Për këto arsye propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike me afat harmonizimi prej 20 ditësh dhe më pas të kryhet mbikëqyrje kontrolli.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.10-4093/1 të datës 04.10.2024 dhe njëzëri konkludoi që SHTR TV SHENJA SHPKNJP Shkup t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafët 1 dhe 3 të LSHMAAV sepse më 11 shtator 2024, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar fillimisht si veprat audiovizuale maqedonase, edhe as të paktën gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar fillimisht si vepra audiovizuale maqedonase, transmetuar në periudhën prej orës 07:00 deri në orën 19:00.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 të datës 07.11.2022, udhëzohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizojë punën e tij me dispozitat e nenit 92 paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Spektori për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Akvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike transmetuesit në fjalë.

Spektori për çështje juridike pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike, të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 10

Ndihmës udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit Lucija Gjirkoviq shpjegoi Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të operatorit Neotel nga Shkupi për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV. Ajo shpjegoi se me datën 5 nëntor të këtij viti është bërë mbikëqyrje e rregullt ndaj këtij operatori, nga ku është konstatuar se ka ritransmetuar shërbime programore që nuk mbulohen me çertifikatën për regjistrim të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV. Në bazë të kësaj propozohet shqiptimi i masës vërejtje publike dhe më pas të zbatohet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse operatori ka vepruar sipas aktvendimit.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të rregullt programore, nr.11-4597/1 të datës 08.11.2024 dhe njëzëri konkludoi që Shoqërisë për telekomunikacion dhe shërbime NEOTEL SHPK eksport-import Shkup t'i shqipton masë vërejtje publike për shkelje të nenit 141 të LSHMAAV dhe në përputhje me pikën 8 të Udhëzimit për caktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) nr.01-4139/1 datë 07.11.2022 udhëzohet që menjëherë pas pranimit të aktvendimit për vërejtje publike të harmonizojë punën e tij me LSHMAAV.

Nga mbikëqyrja u konstatua se Shoqëria për telekomunikacion dhe shërbime NEOTEL SHPK eksport- import Shkup, e cila sipas notifikimit nga AKE mund të kryen veprimtari në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut, me datë 05.11.2024 për shfrytëzuesit e tij ka ritransmetuar shërbimet programore "Gametoon" dhe "MTV Europe" të cilat nuk mbulohen me çertifikatë për regjistrim të shërbimeve programore të dhënë nga Agjencia, që është në kundërshtim me nenin 141 të LSHMAAV.

Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik të hartojë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike operatorit në fjalë.

Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtën e autorit pas skadimit të afatit përcaktuar në Aktvendimin për vërejtje publike të kryen mbikëqyrje kontrolli, për të konstatuar nëse subjekti i mbikëqyrjes (operatori) ka vepruar sipas masës së shqiptuar.

Sektorit për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, aktvendimin e mësipërm ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 11

Z. Trajçevski shpjegoi Propozimin për marrjen e vendimit për Ribalancin e planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024. Ai shpjegoi se me ribalancin nuk do të rriten në tërësi shpenzimet e planifikuara, por do të konvertohen mjetet sipas pozicionit, në vlerë të përgjithshme prej 371.000,00 denarë, dedikuara për rritjen e mjeteve për pagesën e kompensimit mujor për anëtarët e Këshillit të Agjencisë, në shuma prej 300.000,00 denarë, si dhe rritjen e mjeteve të nevojshme për lidhjen e kontratës për furnizim publik të shërbimit - lidhje në internet me hosting të ueb-faqeve ekzistuese të Agjencisë në shumën prej 71.000,00 denarë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendim me të cilin miratohet ribalanci i Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024, nr.0501-248/1, datë 12.01.2024.

Shpenzimet në total të planifikuara sipas Planit financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024 mbeten në nivelin e përcaktuar më parë, përkatësisht arrijnë në 168.546.961,00 denarë.

Me ribalancin sigurohen mjete financiare në shumë totale prej 371.000,00 denarë, destinuar për:

- Rritja e mjeteve për pagesën e kompensimit mujor për anëtarët e Këshillit të Agjencisë në shumë prej 300.000,00 denarë dhe
- Rritja e mjeteve të nevojshme për lidhjen e kontratës për furnizim publik të shërbimit - lidhje interneti me hostim të ueb-faqeve ekzistuese të Agjencisë në shumë prej 71.000,00 denarë.

Spektori për përkrahjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, këtë Vendim ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Pikat 12 dhe 13

Z. Petrushevski, në marrëveshje me drejtorin Trajçevski, propozoi për Pikat 12 dhe 13 të bëhet një hyrje sepse kanë lidhje me Marrëveshjen kolektive e cila është votuar në njërin nga seancat e kaluara dhe më pas secila prej tyre të votohet veçmas.

Z. Trajçevski shpjegoi se këto pika rrjedhin nga Marrëveshja Kolektive e miratuar dhe e nënshkruar, gjegjësisht për t'u përputhur me përmbajtjen e saj dhe nuk ka ndryshime të tjera jashtë saj.

Udhëheqësja e Sektorit për çështje juridike dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska në lidhje me Propozim-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore për pagën bruto dhe kompensime të tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, shpjegoi se ndryshimi themelor që është duke u bërë është mënyra se si llogaritet paga. Në vend të kësaj, siç ka qenë më parë, që paga e të punësuarve përmban pjesë të pagës për komplikim dhe përgjegjësi në vendin e punës, pjesë të pagës për arsimim dhe pjesë të pagës për vitet (punën) e kaluar, tani është përcaktuar se paga bazë bruto e të punësuarve në Agjencion, përbëhet nga paga mesatare bruto, koeficientin e komplikimit në vendin e punës dhe një pjesë të pagës për punën e kaluar (stazhin). Si rezultat, në vend të pikëve, përcaktohet koeficienti i përcaktimit të pagës, i cili koeficienti total i pagës përbëhet nga komplikimi dhe arsimimi plotësues (shtesë) siç thuhet në nenin 9 të rregullore së propozuar. Po ashtu rritet edhe shtesa e pagës në bazë të suksesit në punë, deri më tani ishte 20%, tani përcaktohet maksimumi deri në 30% nga ku janë përpunuar në detaje kriteret mbi bazën e të cilave do të bëhen rritjet. Në thelb këto janë ndryshimet. Ajo theksoi se kjo Rregullore do të hyjë në fuqi nga 1 dhjetori i vitit 2024. Në lidhje me Propozim-rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullore për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor të të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, ajo shpjegoi se është bërë harmonizim në përputhje me Marrëveshjen kolektive dhe një përshtatje tjetër. Nga përvoja e zbatimit është se deri më tani plani për shfrytëzimin e pushimit vjetor deri më tani është sjellë deri në maj, i cili ka rezultuar jo i përshtatshëm, kështu që tani është ndryshuar deri në janar, ku përcaktohet edhe kohëzgjatja e pushimit vjetor. Thelbësore për Rregulloren është se rriten kriteret mbi bazën e të cilave do të llogaritet kohëzgjatja e ditëve të pushimit vjetor. Numri total maksimal që mund të merret është 32 ditë, në ndryshim nga ai i mëparshmi kur ishte 29 ditë.

Z. Petrushevski tha se Këshilli për këtë ka diskutuar në detaje në një nga seancat e mëparshme kur është diskutuar për Marrëveshjen Kolektive, e cila në atë kohë nuk ishte nënshkruar. Ndërkohë, është nënshkruar nga të gjitha palët, nga sindikata shtetërore, lideri lokal dhe drejtori i Agjencisë. Ai deklaroi se do t'i mbështeste të dyja pikat dhe mban të njëjtin qëndrim sepse bëhet fjalë për kushte më të favorshme për të punësuarit. Ai theksoi se të punësuarit meritojnë respekt dhe kushte të mira pune.

Votimi për pikën 12

Këshilli i Agjencisë me 4 vota "pro" dhe një votë abstenim nga z.Jançeski miratoi Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për pagën bruto dhe kompensime tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, me tekstin e propozuar.

Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores për pagën bruto dhe kompensimet tjera të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, të publikohet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë.

Sektori për çështjet juridike dhe furnizim publik të përgatisë Tekst të pastruar.

Votimi për pikën 13

Këshilli i Agjencisë me 4 vota "pro" dhe një votë abstenim nga z.Janceski miratoi Rregulloren për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor të të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, ark.nr.01-1879/1 datë 12.03.2015., ark.nr.01-1879/2 datë 31.03.2015 dhe ark.nr.01-4549/1 datë 17.10.2018., me tekstin e propozuar.

Rregullorja për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për përcaktimin e kohëzgjatjes së pushimit vjetor të të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele të publikohet në tabelën e shpalljeve të Agjencisë.

Sektori për çështje juridike dhe furnizim publik të përgatisë Tekst të pastruar.

Pika 14

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim që drejtori i Agjencisë të marrë vendim për miratimin e mjeteve financiare në vlerë prej 23.000,00 denarë me TVSH të llogaritur 18%, për rinovimin e 2 (dy) qasjeve shfrytëzuese në bazën elektronike të të dhënave në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut", për periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) muajsh.

Shuma e mjeteve për qasje në bazën elektronike të të dhënave në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" është paraparë në Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.

Pika 15

Udhëheqësja e Sektorit për çështje programore dhe furnizim publik, Cvetanka Mitrevska shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Shërbime shtypi. Ajo ka shpjeguar se është paraparë në planin vjetor për furnizim publik të Agjencisë për vitin 2024 dhe mjetet janë të parapara me planin financiar të Agjencisë për vitin 2024. Kontrata që rezulton do të lidhet për periudhë prej një viti. Sipas shumës së mjeteve, do të zbatohet si furnizim me vlerë të ulët me publikim në sistemin elektronik për furnizim publik. Të gjitha të dhënat e tjera mbi pikën janë dhënë në materiale.

Z. Petrushevski tha se bëhet fjalë për furnizim me mjete të parashikura prej rreth 600.000,00 denarë pa TVSH.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Shërbime shtypi.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën-shërbim: Shërbime shtypi është parashikuar dhe është në përputhje me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, dhe mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2024.

Pika 16

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**